



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr 5778/Prot.

Tiranë, më 27. 7. 2017

Lënda: Njoftim për fillimin e procesit të konsultimit publik për Strategjinë e Ujitjes dhe Kullimit në Shqipëri

Drejtuar:	BASHKISË	BERAT
	BASHKISË	DIBËR
	BASHKISË	DURRËS
	BASHKISË	ELBASAN
	BASHKISË	FIER
	BASHKISË	GJIROKASTËR
	BASHKISË	KORÇË
	BASHKISË	KUKËS
	BASHKISË	LEZHË
	BASHKISË	SHKODËR
	BASHKISË	TIRANË
	BASHKISË	VLORË
	DREJTORIA E UJITJES DHE KULLIMIT	FIER
	DREJTORIA E UJITJES DHE KULLIMIT	DURRËS
	DREJTORIA E UJITJES DHE KULLIMIT	LEZHË
	DREJTORIA E UJITJES DHE KULLIMIT	KORÇË
	ORGANIZATËS SË PËRDORUESVE TË UJIT, PIRG	KORÇË
	ORGANIZATËS SË PËRDORUESVE TË UJIT, ÇUKAS	LUSHNJE
	ORGANIZATËS SË PËRDORUESVE TË UJIT, BUSHAT	SHKODËR

Ministria e Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe Admministrimit te Ujerave, ka inicjuar pregatitjen e "Strategjisë së Ujitjes dhe Kullimit në Shqipëri" dhe në zbatim të ligjit nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", do të organizojë konsultimin publik me Organet Publike (Bashkitë, Bordet Rajonale të Kullimit) dhe Grupet e Interesit (Organizatet e Përdoruesve të Ujit etj), në lidhje me Strategjinë e Ujitjes dhe Kullimit në Shqipëri"

Arsuyet e nevojshme për hartimin e “Strategjisë së Ujitjes dhe Kullimit në Shqipëri”:

- Në zbatim të strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 27, ka përcaktuar se bashkitë janë përgjegjëse për : “Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”.
- Për realizimin e këtij funksioni, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr.1108, date 30.12.2015, “Për transferimin, nga Ministria e bujqësisë, zhvillimit rural dhe administrimit të ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”.
- Nëpërmjet këtij vendimi është realizuar transferimi në pronësi i inventarit të rrjetit të ujitjes dhe kullimit që janë administruar nga Bordet e Kullimit nën varësinë e MBZHRAU, si dhe transferimi i një pjese të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të bordeve të kullimit në 61 bashkitë, përfshirë zyra, ekskavatore, punonjës etj.
- Ligjit nr. 24/2017, në nenin 6, përcakton Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) si organin përgjegjës për politikën kombëtare të ujitjes dhe kullimit.
- Në këto kushte, mbështetur në konsulencën e Projektit të Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes, të Bankës Botërore, referuar kontekst të ri, të ndarjes së roleve në administrimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit, midis MBZHRAU dhe 61 Bashkive, MBZHRAU ka konsideruar të nevojshme hartimin e “Strategjisë së Ujitjes dhe Kullimit në Shqipëri” dhe kërkon mendimin tuaj, përpara se kjo strategji të dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave.

Qëllimi i Strategjisë së Ujitjes dhe Kullimit në Shqipëri:

- Strategjia, bazuar në analizën e gjendjen egzistuese, identifikon pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe rreziqet për ujitjen, kullimin, digat dhe rezervuarët si dhe mbrojtjen nga përmbytjet, duke sugjeruar misioni për nën-sektorët e ujitjes dhe kullimit brenda fushës së veprimit të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) që, ka të bëjë me optimizimin e të gjithë investimeve në ujitje, kullim dhe mbrojtjen nga përmbytjet me qëllim zgjerimin dhe bërjen të qëndrueshme të sistemeve të ujitjes, përmbytjet e nevojave për kullim dhe mbrojtjen e popullsisë dhe pronave nga përmbytjet, nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm dhe produktiv të sistemeve të ujitjes dhe kullimit, përmirësimin e përdorimit eficient të ujit dhe shpërndarjen e barabartë, krahas me reduktimin e rezikut nga përmbytjet dhe shkatërimin të digave, duke dhënë një projeksion se si duhet të jete ujitja dhe kullimi në 10 deri 20 vitet e ardhëshme.

Ndikimi që do të ketë Strategjia e Ujitjes dhe Kullimit në Shqipëri:

- Përmirësimi i menaxhimit të sistemeve të ujitjes dhe kullimit nëpërmjet transferimit të përgjegjësisë të ujitjes tek bashkitë/ Organizatat e Përdoruesve të Ujit dhe rolit të drejtorive të ujitjes dhe kullimit në administrimin e infrastrukturës kryesore të ujitjes dhe kullimit;
- Menaxhimi i qëndrueshëm i sistemeve do të reduktojë presionin në financat publike, nëpërmjet decentralizimit të përgjegjësisë dhe përmirësimin të kthimit të kostove;

- Rritja e produktivitetit bujqësor, nëpërmjet plotësimit të vazhdueshëm të nevojave të fermerëve për ujë për ujitje në të gjitha zonat, që mund të ujiten, rreth 360 000 ha; përmirësimi i kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja në të gjitha zonat, që mund të kullohen, në rreth 280 000 ha dhe zvogëlimi i rrezikut nga përmbytjet lumore dhe detare të një sipërfaqe potencialisht të rrezikuar prej 130 000 ha të ultësirës perendimore.
- Përfitues të këtyre shërbimeve janë rreth 300 000 fermerë, që ushtrojnë aktivitet bujqësor dhe banorë të tjerë të zonave rurale.

Afati:

Afati i procesit të konsultimit është deri me datë 28.8.2017, periudhë gjatë së cilës ju mund të konsultoni Strategjinë e Ujitjes dhe Kullimit në Shqipëri dhe mbi këtë bazë mund të dërgoni rekomandimet dhe komentet tuaja tek kordinatori, në rrugë elektronike/shkresë zyrtare në adresën: erola.rada@bujqesia.gov.al

Organizimi i takimit:

- Me datë 29.8.2017, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, ora 11, në sallën e mbledhjeve në katin tretë, do të zhvillohet takimi publik përmbylles, ku jeni të lutur për pjesëmarrje.

Dokumentacioni:

Strategjia e Ujitjes dhe Kullimit në Shqipëri e gjeni të publikuara:

- në faqen elektronike në adresën: www.konsultimipublik.gov.al
- në faqen elektronike të MBZHRAU në adresën: www.bujqesia.gov.al

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM


VOJO BREGU